

PROGRES I REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

JANAR – QERSHOR 2025

Materiali është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Xaira Shurdha, Eksperte e Ndërlidhjes dhe Monitorimit nën udhëheqjen e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) me mbështetjen e z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor e Rregullator dhe znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomie. Materiali është redaktuar nga znj. Elisa Lula, Specialiste e Komunikimit pranë Sekretariatit, duke ofruar mbështetje edhe në përgatitjen e dizajnit. Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në aktivitetet monitoruese, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BER-ZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.


Tiranë, Qershor 2025

ASPEKTET KRYESORE

Që prej prill 2015, Këshilli i Investimeve (KI) ka miratuar 350 rekomandime në 35 mbledhje.

Aktualisht niveli i zbatimit të rekomandimeve në total është 51.1% dhe 16.6% në proces.


Figura 1. Statusi i rekomandimeve të KI, Qershor 2024



Nga përditësimi i fundit në qershor 2025, evidentojmë përshejtim të angazhimit të institucioneve dhe shoqatave të biznesit në lidhje me zgjidhjen e problematikave të aksesit në financim, inovacionit dhe digjitalizimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve) si dhe operacionalizimit të Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA-ve). Këto ndërhyrje përbëjnë gjithashtu një reflektim të angazhimit institucional për të përshejtuar reformat strukturore dhe për të konsoliduar klimën e biznesit sipas standardeve evropiane dhe kërkesave të kapitujve negociues në fushat e zhvillimit ekonomik, konkurrencës dhe mjedisit të favorshëm për investime.

Kështu, nga 17 rekomandime për të cilat institucionet janë angazhuar në zbatim, 14 janë përmbyshur dhe 3 janë në proces zbatimi. Theksojmë, se nga këto rekomandime, 63% e tyre adresojnë ndërhyrje në nivel strategjik e politikash dhe 32% në nivel institucional.

Figura 2. Ecuria e rekomandimeve të KI sipas kategorive, Qershor 2024



Referuar dinamikave ligjore që ndikuan në përparimin e zbatimit të 6 rekomandimeve këtë gjashtë muor, evidentojmë kryesisht:

- o Vendim nr. 13, datë 9.1.2025 për transferimin tek Korporata e Investimeve Shqiptare (KISH) të pronave shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, nr. 310, nr. 324/2, nr. 324/4, zona kadastrale 3852, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe Miratimin e hapjes së Parkut Teknologjik dhe Shkencor "Durana Tech Park"
- o Draft marrëveshje mes MEKI dhe Durana Tech Park me vendim nr. 73, datë 29.1.2025 "Për miratimin e planit të zhvillimit të detajuar dhe draftmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Korporata e Investimeve Shqiptare, "për angazhimet e ndërsjella për ndërtimin, administrimin, menaxhimin, funksionimin, operimin dhe monitorimin e parkut teknologjik dhe shkencor "Durana Tech Park".
- o Vendim nr. 260, datë 7.5.2025 "Për shpalljen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit ekonomik dhe zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Xhafzotaj, Shijak".
- o Vendim nr. 77, datë 5.2.2025 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore"- databaza e treguesve të statistikave zyrtare.

47% e rekomandimeve¹ ndikojnë të gjithë sektorët e biznesit. Nga monitorimi ynë, rezultojnë se shtyllat kryesore ku ka pasur ecuri janë si më poshtë:

PROGRES I REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

JANAR – QERSHOR 2025

A. Skema të Reja, Partneritete Strategjike dhe Angazhim më i madh i Sektorit Bankar për përmirësimin e Aksesit në Financë dhe Inovacionit për NMVM-të në Shqipëri:

Në shkurt 2025, **Banka e Shqipërisë** prezantoi një **skemë të re financimi**² në vlerën prej 25 miliardë lekësh, e dedikuar për mbështetjen e NMVM-ve që operojnë kryesisht në sektorin e bujqësisë, agroturizmit, etj. Skema synon të lehtësojë aksesin në financë për këto biznese përmes kushteve të favorshme kreditimi, me norma të reduktuara interesi që variojnë nga 2% për kreditë e mbuluara me garanci sovrane deri në maksimumi 3.5% për ato të bazuara në analizat e riskut të bankave të nivelit të dytë. Kreditë ofrohen në lekë dhe ekskluzivisht për investime, duke përkrahur kështu zhvillimin afatgjatë të bizneseve. Skema është aktualisht në fazë zbatimi nga bankat.

Gjithashtu, janë ndërmarrë disa marrëveshje për forcimin e aksesit në financë për NMVM-të, me mbështetje nga institucione ndërkombëtare. **Union Bank ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bashkimin Evropian (BE)**³ për krijimin e një **fondi të dedikuar për digjitalizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme** përmes dy programeve (1) “Bëhu digjital” që do të mbështesë digjitalizimin dhe modernizimin e tyre, si dhe do të nxisë investimet e gjelbra, (2) “Të rinjtë në biznes” që synon të rrisë qasjen në financë për bizneset e vogla në pronësi ose të drejtuara nga sipërmarrës të rinj, duke synuar rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së tyre. Në të njëjtën kohë, **ProCredit Bank ka konsoliduar partneritetin me BERZH**⁴ për të ofruar financim të qëndrueshëm për NMVM-të në kuadër të “Programit të Rinisjes së Qëndrueshme për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Ballkanin Perëndimor” (Sustainable Reboot Programme for SMEs in the WB), një iniciativë që promovon investime të gjelbra, eficientë energjike dhe zhvillim të qëndrueshëm për bizneset në Shqipëri.

Në janar 2025, **Banka e Shqipërisë dhe Banka Evropiane e Investimeve nënshkruan një marrëveshje strategjike për zhvillimin e financave të gjelbra në vend, e cila parashikon hartimin e një Taksonomie të Gjelbër**⁵ për klasifikimin e aktiviteteve të qëndrueshme, mbështetje për bankat në mobilizimin e fondeve për projekte të gjelbra, ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve klimatike si dhe përgatitjen për përafrim me

2 <https://shorturl.at/In5hJ>
3 <https://shorturl.at/faXcd>
4 <https://shorturl.at/NgYKE>
5 <https://shorturl.at/34NeT>

Programi/Agjencia	Periodha e fillimit	Vlerat e Financimit
Agjencia Startup Albania – Programi i Financimit 2025	Dhjetor 2024	Deri në 100% të kostove në varësi të kategorizimit të biznesit
AIDA & MEKI– Mbështetje për Zhvillimin e Biznesit	Shkurt, 2025	Deri në 2.5 milion ALL (~€25,000)
Fondi i Sfidës së Inovacionit – Faza 2	Prill 2024	
Projekti “BE për Inovacionin” (EU4I)	Shkurt 2025	
EBRD & EU – “Bëhu Dixhital në Ballkanin Perëndimor”	Prill 2025	€377 milion (Program rajonal)

standardet e BE-së në këtë fushë. Megjithatë, mbetet një hendek i konsiderueshëm sa i takon mungesës së produkteve financiare të dedikuara për gratë në biznes, një aspekt që nuk evidentohet as në skemën e re të Bankës së Shqipërisë dhe as në marrëveshjet tregtare ekzistuese, duke kërkuar vëmendje të shtuar në përputhje me rekomandimet për përfshirje financiare gjinore.

Gjatë fundit të vitit 2024 dhe fillim 2025, disa nisma të reja financiare janë ndërmarrë për fuqizimin e NMVM-ve dhe inovacionit në vitin 2025.

Në mungesë të një strategjie të integruar kombëtare për edukimin financiar të udhëhequr nga Banka e Shqipërisë apo Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), disa banka tregtare kanë ndërmarrë iniciativa të veçuara në promovimin e njohurive financiare dhe mbështetjen për sipërmarrjen⁶. Union Bank ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësismit te studentët për menaxhimin e rreziqeve financiare përmes leksioneve të hapura, si dhe ka bashkëpunuar me BERZH dhe BE për të mbështetur digjitalizimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes një fondi prej 5 milionë euro. Po ashtu, ProCredit Bank ka përfshirë edukimin financiar në panairë kombëtare dhe ka ndarë njohuri praktike për gratë në punë në kuadër të Javës Globale të Parasë. Këto ndërhyrje tregojnë për një përpjekje të decentralizuar të sistemit bankar për të avancuar edukimin financiar dhe përfshirjen në tregun formal, megjithatë, mungesa e një platforme të përbashkët dhe gjithëpërfshirëse kombëtare kufizon shkallën e ndikimit dhe kohezionin e këtyre përpjekjeve.

Në funksion të nxitjes së inovacionit dhe digjitalizimit të NMVM-ve, janë ndërmarrë hapa konkretë për të ndërtuar një infrastrukturë mbështetëse përmes zhvillimit të qendrave të inovacionit si baza të

6 <https://shorturl.at/bDy4m>

rëndësishme për rritjen e kapaciteteve inovative dhe përmirësimin e aksesit në financime të dedikuara për teknologji dhe zhvillim të qëndrueshëm. Pesë qendra janë krijuar dhe janë tashmë pjesë e Rrjetit Evropian të Qendrave për Inovacionin Digjital (EDIH), duke u integruar në platformën zyrtare të BE-së dhe duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për digjitalizimin e NMVM-ve, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe institucioneve publike. Paralelisht, përmes Programit READ të mbështetur nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), është nxitur angazhimi i diasporës akademike në projekte të kërkimit dhe inovacionit, duke krijuar ura efektive bashkëpunimi që sjellin në vend ekspertizë ndërkombëtare, dije të përparuara dhe praktika të mira në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të NMVM-ve.

B. Përpjekje për Formalizimin e Ekonomisë dhe Mbështetjen e NMVM-ve

Miratimi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027 (VKM nr. 847, datë 26.12.2024) është një hap i rëndësishëm drejt formalizimit të sektorit privat, pasi **synon përmirësimin e mbledhjes së taksave dhe forcimin e administrimit fiskal**. Strategjia është hartuar në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare dhe bazohet edhe në konsultime me publikun. Ajo synon të krijojë kushte më të qarta dhe më transparente për funksionimin e bizneseve, duke nxitur regjistrimin dhe deklarimin e plotë të veprimtarive të tyre. Megjithatë, për disa objektiva më afatgjatë që lidhen me rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës, do të nevojitet një vlerësim më i detajuar për të kuptuar sa dhe si do të zbatohen në praktikë.

Në mars 2025, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe kompaninë ndërkombëtare

PROGRES I REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

JANAR – QERSHOR 2025

Mastercard, prezantuan **Programin Kombëtar për Përsheptimin e Pagesave Elektronike⁷ (POSI)**, me fokus të drejtpërdrejtë në formalizimin e sektorit privat. Programi synon zgjerimin masiv të përdorimit të pajisjeve POS në të gjithë vendin, duke ofruar për biznese të përzgjedhura një periudhë përdorimi 12-mujore pa komision. Duke pasur në fokus biznese të vogla si ato të akomodimit, restoranteve dhe shërbimeve të transportit, kjo nismë synon të përshpejtojë kalimin drejt transaksioneve elektronike, duke kufizuar përdorimin e parasë fizike dhe duke forcuar gjurmueshmërinë ekonomike. Përmes këtij mekanizmi, synohet të reduktohet informaliteti dhe të promovohet një kulturë fiskale më e përgjegjshme, e mbështetur edhe nga fushata ndërgjegjësuere në media.

Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 5.2.2025, **për krijimin e databazës shtetërore të treguesve të statistikave zyrtare, synon të përmirësojë informacionin mbi NMVM** duke ofruar të dhëna të detajuara për aktivitetin e tyre. Kjo databazë do të ndihmojë institucionet publike të kenë akses më të mirë dhe më të përditësuar në të dhëna të besueshme, të nevojshme për ndjekjen e zhvillimeve në sektorin privat dhe për hartimin e politikave më efektive. Përmes këtij mekanizmi, pritet të rritet transparencja ekonomike, të lehtësohet mbështetja për bizneset përmes masave fiskale dhe digjitalizimit, dhe të përmirësohet ndërhyrja institucionale për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

C. Ndërhyrje të synuara për mbështetjen e financimit, sigurimit dhe eksportit në sektorin bujqësor

Në fillim të 2025, u prezantua **skema e garancisë sovrane për bujqësinë⁸, si një instrument praktik për të përmirësuar aksesin në financë për fermerët dhe agrobizneset. Skema synon të lehtësojë kreditimin duke ofruar norma interesi të subvencionuara nga 2% deri në 3.5% dhe mbulim deri në 70% të shumës së kredisë pa kolateral** përmes fondit të garancisë së shtetit. Programi është i vlefshëm deri në fund të vitit 2025 dhe synon të nxisë investimet në zonat rurale, të rrisë nivelin e formalizimit dhe të përmirësojë kapacitetin konkurrues të sektorëve të përfshirë. Sipas MBZHR dhe AZHBR, interesi i treguar nga fermerët është i lartë, duke reflektuar nevojën reale për mjete financimi të përshtatshme dhe të përbalueshme për zhvillimin bujqësor.

Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të krijimit të skemave të sigurimeve në bujqësi, përmes

bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Në dhjetor 2024, Shqipëria nisi bashkëpunimin me Qeverinë Turke për ndarjen e përvojës dhe ngritjen e skemave të mbulimit për produktet bujqësore. Ky bashkëpunim u konkretizua në **mars 2025 me nënshkrimin e Planit të Veprimit për Zhvillimin e Sigurimeve në Bujqësi, i cili përfshin zgjerimin e partneriteteve, shkëmbimin e ekspertizës, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen financiare për fermerët.**

Krahas zhvillimeve institucionale, ka pasur një intensifikim të kërkimeve akademike⁹ që analizojnë gatishmërinë e fermerëve për të paguar për sigurimin bujqësor dhe vlerësimin e riskut në këtë sektor. Studime të realizuara nga akademikë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, si në kuadër të projektit READ të financuar nga AADF, kanë ndihmuar në krijimin e një baze teknike për hartimin e skemave të sigurimit. Megjithëse iniciativat nuk janë tërësisht të udhëhequra nga qeveria, krijimi i kësaj baze analitike dhe rritja e ndërgjegjësisimit mund të konsiderohen një progres i pjesshëm në këtë drejtim.

Në përputhje me rekomandimin për ngritjen e një Portali Sektorial të Eksportit, është vlerësuar si një hap pozitiv **krijimi i platformës Export Albania, zhvilluar nga AIDA në bashkëpunim me MEKI dhe GIZ.** Kjo platformë synon të mbështesë ndërkombëtarizimin e NMVM-ve shqiptare përmes ofrimit të informacionit mbi tregjet e huaja, përgatitjes për pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, asistencës teknike, udhëzuesve për eksport dhe mundësisë për rrjetëzim me kompani të huaja përmes lidhjes me platformën ndërkombëtare Kompass. Platforma përfshin komponentë të rëndësishëm si rregullore doganore (edhe pse me manual orientues të vitit 2018), raporte analitike të përzgjedhura mbi tendencat e tregut, një kalendar me evente dhe panaire për informimin e bizneseve, si dhe mundësinë për të ndërtuar profile prezantuese të kompanive. Ndërkohë janë zhvilluar edhe guida eksporti për pesë shtete partnere dhe një mjet vetëvlerësimi për gatishmërinë për eksport. Megjithatë, mungesa e përditësimit të rregullt dhe e thelluar e disa moduleve kufizon funksionalitetin e plotë të platformës si një mjet dinamik dhe gjithëpërfshirës për bizneset eksportuese shqiptare. Ndërkohe mbetet ende e papërfunduar Strategjia (Programi) Kombëtar i Eksporteve sipas parashikimeve në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS). Në këtë kuadër, **ndërhyrja ka një bazë të qartë institucio-**

9 “Analiza e Rrezikut dhe Vlerësimi i Skemave të Sigurimit Bujqësor në Shqipëri”, 2025 https://www.researchgate.net/publication/389396202_Risk_Analysis_and_Premium_Assessment_in_Albanian_Agricultural_Insurance

“Assessing Farmers’ Willingness to Pay for Agricultural Insurance in Albania”, 2025 Edvin Zhllima dhe Ardian Harri,

“Farmers’ Awareness and Approach to Agricultural Insurance as a Risk Mitigation Strategy”, shtator 2024 <https://www.ejbm.org/index.php/ejbm/article/view/2469>

nale dhe strukturore, por kërkon forcim në përmbajtje, përditësim të informacionit, integrim të statistikave të tregtisë së jashtme dhe krijimin e shërbimeve të personalizuar për eksportuesit.

D. Operacionalizimi i TEDA-ve, duke e kthyer këtë instrument nga një koncept teorik në platformë konkrete për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për nxitjen e inovacionit e teknologjisë në nivel vendi.

Në lidhje me rekomandimet e KI për shfrytëzimin e zonave të lira ekonomike (TEDA) si hapësira për zhvillimin e teknologjive dhe trajnimeve, gjatë vitit 2025 janë evidentuar zhvillime konkrete që përfaqësojnë një rikthim të fokusit strategjik tek këto zona. Në fillim të vitit, u firmos marrëveshja për TEDA Tiranë (Kashar) me kompaninë izraelite “H.A.P.I Advanced Technologies LTD”, duke mundësuar një investim të rëndësishëm në teknologji dhe inovacion. Zona mbulon 35 hektarë dhe synon të tërheqë industri të avancuara si ajo automobilistike, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, elektronikë, farmaceutikë dhe agropërpunim. Në fazën e dytë, kjo zonë synon të krijojë rreth 7,000 vende pune me paga të larta dhe kushte moderne.

Në fillim të vitit 2025 është miratuar zyrtarisht **hapja e Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park”**, përmes vendimit nr. 13, datë 9.1.2025 . Më tej, me Vendimin nr. 73, datë 29.1.2025 , është miratuar marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, për ndërtimin, administrimin dhe funksionimin e parkut. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një zone të specializuar për teknologji dhe inovacion, me potencial për tërheqje investimesh dhe rritjen e kapaciteteve vendase në fusha strategjike. Me Vendimin nr. 260, datë 7.5.2025 , është shpallur zyrtarisht Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Xhafzotaj, Shijak, duke njohur zyrtarisht edhe zhvilluesin e saj. Zona do të shërbejë si qendër për investime në industri prodhuese, TIK, elektronikë, energji, agropërpunim, eksport-import dhe shërbime të lidhura, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Përtej ecurisë pozitive të rekomandimeve të mësipërme, evidentojmë ende 113 rekomandime të paplotësuara, të detajuara sipas temës në grafikonin e mëposhtëm.¹⁰


7 <https://shorturl.at/ilqhC>
8 <https://azhbr.gov.al/aksesi-ne-finance/>

10 % përkatëse për secilën temë bazohet mbi totalin e rekomandimeve të paplotësuara (113).

PROGRES I REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

JANAR – QERSHOR 2025

Figura 3. Rekomandime të paplotësuara, Qershor 2025¹¹



Rekomandimet e lidhura me “Potencialet e Investimeve” dhe “Sigurinë Juridike mbi Pronën” vijnë të mbeten ndër më pak të avancuarat në zbatim, duke reflektuar sfidat e vazhdueshme që lidhen me krijimin e një kuadri më tërheqës dhe të besueshëm për investitorët. Progresi në këto drejtime mbetet thelbësor për të përmirësuar klimën e investimeve, për të rritur sigurinë ligjore të pronës dhe për të kontribuar në ndërtimin e një mjedisi ekonomik më të qëndrueshëm dhe konkurrues. Disa nga rekomandimet e paplotësuara që i konsiderojmë të rëndësishme për zbatim janë:

¹¹ Tek “të tjera” përfshihen rekomandime të paplotësuara të dhëna në mbledhjet: “Nga pagat tek produktiviteti në punë”, “Inspektimet”, “Informaliteti”, “Informaliteti në Bujqësi”, “Ankimimi Administrativ”, “Fuqia Punëtore -BPO”, “Procedurat Doganore”.

Këshilli i Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga një sekretariat i përbërë prej një grupi të pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatin e KI, sigurohet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

- Strategjia kundër informalitetit** – Hartimi dhe miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse me plan veprimi, afate dhe institucione përgjegjëse, në konsultim me biznesin.
- Pronat publike** – Regjistrimi dhe publikimi i aseteve të bashkive në ASHK; përdorimi i tyre për zhvillim ekonomik dhe të ardhura vendore.
- Transparencë dhe akses në të dhëna** – Kadastër Digjital online dhe pa kufizime për publikun; publikimi i fondit të pronave për investime strategjike.
- Koordinimi i investimeve publike** – Monitorimi i projekteve qendrore e vendore për të siguruar përputhje me strategjitë prioritare.
- Fuqizimi i shoqatave të biznesit** – Rritja e kapaciteteve për përfaqësim, advokim dhe pjesëmarrje efektive në konsultimet e politikave publike.
- Ndryshim kulture në menaxhimin e burimeve njerëzore** – Trajnime për drejtuesit e NMVM-ve mbi vlerësimin e kapitalit njerëzor si aset dhe jo si kosto.
- Investime në teknologji** – Mbështetje për automatizim dhe bashkëpunim me qendrat e formimit për rikualifikimin e stafit.
- Stimulim fiskal për K&ZH** – Politika fiskale që nxisin ndërmarrjet të dedikojnë burime për kërkimin dhe zhvillimin.
- Shkëmbimi i të dhënave me bashkitë** – Përditësim në kohë reale i të dhënave mbi detyrimet dhe statusin e bizneseve; standardizim i formateve për bashkëpunim me bankat.

SHKURTIME

KM	Këshilli i Ministrave
KI	Këshilli i Investimeve
MF	Ministria e Financave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit